


Arven Syla dhe Olsë Kajtazi

Siguria Energjetike dhe Rëndësia e Mjaftueshmërisë Energjetike

Vlerësim i Kuadrit Rregullativ të Kosovës
Kundër Cenueshmërisë së Prodhimit



Imprint

Botuesi

Friedrich-Ebert-Stiftung, Zyra në Prishtinë
Rr. Pashko Vasa Nr. 23
10000 Prishtinë
Republika e Kosovës

Përgjegjësia për përmbajtjen dhe redaktimin

Katharina Hofmann

Kontakti

Rudina Nallbani
rudina.nallbani@fes.de

Dizajni/Faqosja

Trembelat

Shtypja dhe prodhimi

Studio Forma

Ky dokument është shkruar fillimisht në anglisht. Në rast të ndonjë paqartësie ose mospërputhjeje, ju lutemi referojuni versionit në anglisht të dokumentit. Pikëpamjet e shprehura në këtë botim nuk janë domosdoshmërisht ato të Friedrich-Ebert-Stiftung e.V. (FES). Përdorimi komercial i mediave të publikuara nga FES nuk lejohet pa pëlqimin me shkrim të FES. Publikimet e FES nuk mund të përdoren për qëllime fushate zgjedhore.

Prill 2026

© Friedrich-Ebert-Stiftung e.V.

Publikime të mëtejshme të Friedrich-Ebert-Stiftung mund të gjenden:

➤ www.fes.de/publikationen



Arven Syla dhe Olsë Kajtazi

Siguria Energjetike dhe Rëndësia e Mjaftueshmërisë Energjetike

*Vlerësim i Kuadrit Rregullativ të Kosovës
Kundër Cenueshmërisë së Prodhimit*

Përmbajtja

Përmbajtja	2
Hyrje	4
Metodologjia	6
Pasiguritë dhe Goditjet në Sektorin e Energjisë	9
Kuadri rregullativ	13
Zbatimi i Kornizës Analitike të Politikave	17
<i>Ligji nr. 05/L-081 për Energjinë</i>	17
<i>Ligji për Energjinë Elektrike nr. 05/L-085</i>	19
<i>Ligji për Eficiencën e Energjisë nr. 06/L-079</i>	20
<i>Ligji për Rregullatorin e Energjisë nr. 05/L-084</i>	22
<i>Strategjia Kombëtare për Energji 2022 - 2031</i>	23
<i>Plani Kombëtar i Energjisë dhe Klimës (PKEK)</i>	25
<i>Strategjia dhe Plani Kombëtar për Zhvillim (SPKZH) 2030</i>	26
Diskutimi i gjetjeve	28
Konkluzione dhe Rekomandimet	31

Rekomandimet Kryesore

Rekomandimet kyçe në vijim synojnë ndërtimin e një kuadri rregullativ më rezilient për t'u përballur me goditjet që lidhen me mjaftueshmërinë e energjisë:

- Është thelbësore të zhvillohen kapacitete të reja vendore të prodhimit për të rritur rezilencën e sistemit dhe sigurinë e furnizimit. Është e domosdoshme që sektori energjetik i Kosovës ta reduktojë varësinë nga termocentralet ekzistuese me qymyr dhe t'i diversifikojë burimet e furnizimit me energji (burimet e prodhimit si dhe fleksibilitetin). Prandaj, politikëbërësit duhet të krijojnë një kuadër rregullativ të qëndrueshëm që mundëson zbatimin e shpejtë dhe të përsëritshëm të projekteve të reja. Është i nevojshëm një konsensus i gjerë politik ndërmjet partive për t'i mbrojtur investimet afatgjata dhe për të siguruar që projektet energjetike nuk i ekspozohen rrezikut politik.
- Forcimi i kapaciteteve institucionale dhe hartimi i politikave adaptive: Politikëbërësit duhet të rrisin kapacitetet rezervë institucionale dhe të forcojnë kapacitetet për të reaguar ndaj goditjeve përmes formimit të task-forceve të posaçme për energji dhe hartimit të politikave të mençura dhe adaptive.
- Politikëbërësit dhe institucionet duhet të hartojnë plane gjithëpërfshirëse veprimi për përgatitje ndaj rreziqeve, me qëllim që të parashikohen dhe menaxhohen rreziqet nga goditjet e mundshme në të ardhmen. Ato plane duhet të mbështeten në përvojat e viteve të fundit (çmimet e larta të energjisë apo ndërprerjet e shpeshta të furnizimit) për të kaluar nga qasja reaguese në qasje më proaktive të planifikimit.

Shënim

- Ky dokument politikash është hartuar si pjesë e projektit “Vlerësimi i reziliencës së shoqërisë kosovare ndaj goditjeve ekologjike dhe institucionale”. Një bazë të dhënash gjithëpërfshirëse e vlerësimit, e cila mbështet analizën e paraqitur këtu është në dispozicion me kërkesë. Ju lutemi dërgoni kërkesat tuaja te info@re-actlab.org.

Hyrje

Cenueshmëria e sistemeve energjetike ndaj goditjeve të jashtme ka qenë evidente që disa dekada. Së pari më 1973, bota u përball me një krizë madhore energjetike dhe rritje të çmimeve të energjisë pasi vendet arabe ndërprejnë furnizimet me naftë drejt Shteteve të Bashkuara dhe disa vende të tjera, si përgjigje ndaj mbështetjes së tyre për Izraelin gjatë Luftës së Jom Kipurit. Vetëm disa vite më vonë, më 1979, u përjetua një tjetër krizë pas Revolucionit Iranian, duke lënë popullsinë globale me mungesë furnizimesh energjetike dhe rritje të larta çmimesh. Përkundër përpjekjeve të vazhdueshme për të aplikuar alternativa më të pastra energjetike, si burimet e ripërtëritshme, nafta dhe gazi do të vazhdojnë të luajnë rol kyç në miksin global të energjisë. Prandaj, vazhdon të jetë jetike vëmendja e vazhduar në stabilitetin e tyre, pasi ekspertët paralajmërojnë se ndërprerjet e furnizimit në të ardhmen mund të jenë edhe më të mundshme se sot.

Së fundmi në Evropë, pushtimi rus i Ukrainës në vitin 2022 ka ekspozuar sërish varësinë e Evropës në importe të gazit dhe ka shfaqur cenueshmërinë e sektorit energjetik në furnizime të paqëndrueshme me gaz, gjë që rezultoi në rritje të çmimeve të energjisë. Rritjet pasuese të çmimeve të energjisë prekën pjesën më të madhe të Evropës, përfshirë Kosovën, duke lënë ekonominë familjare dhe bizneset nën presion financiar dhe me mbrojtje të pamjaftueshme. Këto kriza shpërfaqin rëndësinë e reziliencës së sistemeve aktuale energjetike kur ekspozohen ndaj goditjeve të jashtme, si dhe nevojën për të hartuar politika dhe programe që mund të zbusin dhe menaxhojnë pasojat e tyre në kohë krize.

Tradicionalisht, koncepti i sigurisë së energjisë kishte kryesisht në fokus sigurimin e furnizimit të vazhdueshëm, të qëndrueshëm dhe të përballueshëm me energji për popullsinë, ku shqetësimi kryesor ishte disponueshmëria e naftës dhe gazit dhe varësia nga importet. Megjithatë, përgjatë viteve, sistemet energjetike kanë pësuar transformime të ndikuara nga rritja e burimeve të ripërtëritshme të energjisë (si dielli dhe era), rritje të elektrifikimit, digjitalizimit dhe ndërlidhjes,

“Ditëve të sotme është shfaqur në pah një koncept më i gjerë dhe shumëdimensional, gjegjësisht rezilienca energjetike, që përshkruan kapacitetin e një sistemi për të absorbuar, për t’u përshtatur dhe për t’u rikuperuar nga goditjet.”

duke çuar në ndryshime të rëndësishme në natyrën e rreziqeve ndaj të cilave mund të ekspozohen sistemet energjetike. Ditëve të sotme është shfaqur në pah një koncept më i gjerë dhe shumëdimensional, gjegjësisht rezilienca energjetike, që përshkruan kapacitetin e një sistemi për të absorbuar, për t'u përshtatur dhe për t'u rikuperuar nga goditjet. Ajo përfshin jo vetëm kapacitetet teknike, por edhe ato institucionale, sociale dhe ekonomike për t'i menaxhuar ndërprerjet që pasojnë nga lloje të ndryshme goditjesh, përfshirë ngjarje mjedisore, gjeopolitike, kibernetike dhe ekonomike apo të bazuara në treg.

Në kontekst të Kosovës, sistemi i energjisë elektrike varet në masë të madhe në kapacitetet e prodhimit me bazë të linjtit nga termocentralet e vjetruara Kosova A dhe Kosova B. Kapaciteti i instaluar i prodhimit dominohet nga qymyri, me rreth 960 MW, pasuar nga kapacitetet e erës (140 MW), hidrocentralet (130 MW) dhe kapacitetet fotovoltaike (30 MW). Për shkak të faktorit të lartë të shfrytëzimit të kapacitetit, qymyri përbën më shumë se 90% të prodhimit total të energjisë elektrike. Prandaj, sistemi i energjisë elektrike karakterizohet me prodhim bazë, duke rezultuar në sistem energjetik jofleksibil, me importet që zakonisht realizohen gjatë orëve të pikut dhe eksportet gjatë orëve të vona të natës. Konsumi i energjisë elektrike ndryshon ndjeshëm sipas stinëve. Dimrat e ftohtë sjellin kërkesë të lartë (nxitur kryesisht nga ngrohja), ndërsa verat tradicionalisht karakterizohen me konsum më të ulët. Megjithatë, për këtë të fundit, si pasojë e valëve të të nxehtit dhe rritjes së nevojës për ftohje, kërkesa, veçanërisht në kohë të pikut, është duke shënuar rritje. Niveli i kapacitetit të energjisë së ripërtëritshme mbetet i kufizuar pavarësisht potencialit të lartë teknik. Politikëbërësit janë në dijeni për këto sfida, prandaj dhe dokumentet strategjike përfshijnë plane për rehabilitimin e blloqeve Kosova A dhe Kosova B, zhvillimin e kapaciteteve të reja prodhuese, uljen e humbjeve të energjisë, rritjen e fleksibilitetit të sistemit dhe modernizimin e rrjeteve të energjisë elektrike. Megjithatë, këto reforma të planifikuara janë afatgjata, dhe rezilienca e Kosovës ende kushtëzohet nga progresi i tyre eventual.

Pjesa tjetër e kësaj analize është strukturuar si vijon: fillimisht paraqesim një përmbledhje të shkurtër të metodologjisë, e cila mbështetet në kornizën e 4R-ve të Reziliencës. Më pas vijon kapitulli mbi kornizën rregullative, ku identifikojmë dhe analizojmë dokumentet kyçe (ligjet, rregulloret dhe dokumentet strategjike) të cilat formësojnë reagimin e Kosovës ndaj kësaj goditjeje. Pastaj zbatojmë kornizën analitike të politikave dhe diskutojmë gjetjet kryesore. Në fund, paraqesim përfundimet dhe rekomandimet.

Metodologjia

Kjo përmbledhje politikash është pjesë e një hulumtimi më të gjerë mbi goditjet institucionale me të cilat përballet Kosova. Ky hulumtim aplikon një kornizë sistematike të analizimit të politikave, e projektuar për të vlerësuar reziliencën e kornizës ekzistuese rregullatore të Kosovës (politika, ligje, akte nënligjore, strategji, dokumente qeveritare etj.) ndaj disa goditjeve. Procesi i hulumtimit ka ndjekur një rrjedhë të strukturuar të përbërë nga tri faza kryesore: (i) identifikimi i natyrës së goditjes, (ii) vlerësimi i reagimeve aktuale të politikave përmes një sistemi të vlerësimit, dhe (iii) hartimi i rekomandimeve të bazuara në gjetjet dhe praktikatat më të mira.

Klasifikimi i natyrës së goditjeve bazohet në kuadrin e zhvilluar nga OECD në vitin 2014, siç shpjegohet në tabelën më poshtë:

Tabela 1. Klasifikimi i goditjeve

Llojet e goditjeve	Karakteristikat	Shembuj
Goditjet kovariante (Të përhapura, sistemike dhe jo të shpeshta)	Ngjarje në shkallë të gjerë që kanë ndikim në një pjesë të madhe të popullsisë përnjëherë. Nuk ndodhin shpesh, por ndikimi i tyre është i gjerë dhe sistematik.	Konfliktet e dhunshme dhe krizat politike, pandemitë dhe krizat shëndetësore, fatkeqësitë natyrore në nivel të gjerë, kërcënimet kibernetike dhe hibride.
Goditjet sezonale (Të përsëritura, të parashikueshme dhe të lokalizuara)	Goditje periodike që ndodhin në intervale të rregullta, shpeshherë të lidhura me ndryshimet sezonale ose trendet klimatike. Zakonisht të parashikueshme, por mungesa e përgatitjes adekuate mund ta përkeqësojë ndikimin e tyre.	Përmbytjet dhe thatësitat vjetore, valët e nxehtësisë dhe të ftohtit, pasiguritë sezonale të ushqimit, rreziqet shëndetësore që përsëriten.
Stresorët afatgjatë (Erozion i ngadalshëm, kumulativ dhe sistematik i reziliencës)	Ndryshe nga goditjet, stresorët afatgjatë zhvillohen ngadalë, përgjatë kohës, dhe dobësojnë sistemet shoqërore. Ata janë shpeshherë goditje strukturore, mjedisore, ekonomike ose shoqërore që kërkojnë reagim politikash.	Degradimi mjedisor, ndryshimet demografike, stagnimi ekonomik dhe pabarazia, institucione dhe qeverisje të dobëta.

Për të vlerësuar efektivitetin e kuadrit rregullator në përballimin e goditjeve të ndryshme, mbështetemi në kornizën e 4R-ve të Reziliencës. Kjo kornizë vlerëson politikatat kundrejt katër dimensioneve kryesore të reziliencës:

Tabela 2: 4R-të e Kornizës së Reziliencës

Korniza	Kategoria	Përkufizimi
4R-të e Reziliencës	Qëndrueshmëria (Robustness)	Fuqia apo aftësia e elementeve, sistemeve dhe njësive të tjera të analizës për t'i bërë ballë një niveli të caktuar stresi ose kërkesë pa pësuar degradim apo humbje funksioni.
	Kapacitetet rezervë (Redundancy)	Disponueshmëria e burimeve alternative gjatë procesit të rimëkëmbjes së një sistemi.
	Resurset	Kapaciteti për t'i identifikuar problemet, përcaktuar prioritetet dhe mobilizuar resurset kur mbizotërojnë kushte që mund të rrezikojnë ndërprerjen e ndonjë elementi, sistemi ose njësie tjetër të analizës.
	Shpejtësia (Rapidity)	Kapaciteti për t'i përmbushur prioritetet dhe arritur objektivat në kohë, në mënyrë që të kufizohen humbjet dhe të evitohen pengesat e ardhshme.

Çdo burim i identifikuar si pjesë e kuadrit rregullator që adreson goditjet vlerësohet kundrejt kuadrit të 4R-ve duke përdorur një sistem të strukturuar vlerësimi, siç shpjegohet më poshtë:

Tabela 3. Sistemi i vlerësimit i bazuar në Kornizën e 4R-ve

Vlerësimi	
Qëndrueshmëria (Robustness)	<p>0: Mungesë e qëndrueshmërisë - politika nuk adreson stabilitetin përballë goditjeve.</p> <p>1: Masa të dobëta ose simbolike me pak zbatim.</p> <p>2: Ka mekanizma të moderuar, por nuk zbatohen në mënyrë konsistente.</p> <p>3: Mekanizma të fortë me zbatim të mirë që sigurojnë stabilitet.</p>
Kapacitetet rezervë (Redundancy)	<p>0: Nuk ka kapacitete rezervë - dështimi i sistemit kryesor çon në kolaps.</p> <p>1: Alternativa minimale ose joformale që nuk janë të besueshme.</p> <p>2: Ka pak kapacitete rezervë, por ekzistojnë zbrazëtira në mbulim ose efikasitet.</p> <p>3: Kapacitete rezervë të mirë integruara që sigurojnë vazhdimësinë nën stres/goditje.</p>
Resurset	<p>0: Nuk ka resurse - qasje reaktive në vend të asaj proaktive.</p> <p>1: Përshtatshmëri e kufizuar - mekanizmat e reagimit janë të dobët ose ad hoc/momental.</p> <p>2: Aftësi mesatare për t'i mobilizuar resurset, por ende ka boshllëqe.</p> <p>3: Mekanizma reagimi shumë fleksibil dhe të koordinuar mirë.</p>
Shpejtësia (Rapidity)	<p>0: Nuk ka mekanizma të reagimit të shpejtë - reagime të vonuara ose mungojnë fare.</p> <p>1: Reagim i ngadaltë dhe burokratik me joefikasitete të mëdha.</p> <p>2: Shpejtësi mesatare, por me disa pengesa.</p> <p>3: Reagim shumë efikas dhe i shpejtë që siguron veprim të shpejtë.</p>

Nota totale e reziliencës së politikave (0-12) normalizohet më pas në përqindje, duke mundësuar vlerësim krahasues midis politikave dhe sektorëve të ndryshëm.

$$\text{Rezultati i reziliencës} = \text{SHUMA (Rezultati total/12)} \times 100$$

Tabela 4. Interpretimi i vlerësimit

Interpretimi i vlerësimit		
0-25% (0-3 pikë)	Reziliencë shumë e ulët	Politika e lë shoqërinë në nivel tejet të ndjeshëm ndaj goditjeve, duke ofruar pak mbrojtje ose aftësi reagimi.
26-50% (4-6 pikë)	Reziliencë e ulët	Ekzistojnë disa masa të reziliencës, por ato janë të dobëta, jokonsistente ose të paplota.
51-75% (7-9 pikë)	Reziliencë mesatare	Politika siguron një nivel të arsyeshëm të përgatitjes dhe reagimit, por mbesin disa boshllëqe kritike.
76-100% (10-12 pikë)	Reziliencë e lartë	Politika është e hartuar mirë, me mekanizma të fortë që sigurojnë stabilitet, përshtatshmëri dhe reagim të shpejtë.

Për metodologji më të detajuar hulumtuese, ju lutemi referojuni Kornizës së Analizimit të Politikave të hartuar për këtë hulumtim. Mund ta gjeni në këtë [link](#).

Pasiguritë dhe Goditjet në Sektorin e Energjisë

Sektori i energjisë elektrike në Kosovë është një nga shtyllat kryesore të sektorit të përgjithshëm energjetik. Ana e konsumit është e elektrifikuar në nivel relativisht të lartë (p.sh. kërkesa termike, si ajo për ngrohje të hapësirave dhe ujit sanitar, si dhe ftohje), ndërsa funksionimi i sektorit të energjisë elektrike varet shumë nga termocentralet e vjetruara dhe të pasigurta me qymyr, që rezultojnë në ndërprerje të shpeshta. Një komponent kritik i reziliencës energjetike është mjaftueshmëria e furnizimit me energji elektrike, që përkufizohet si aftësia e sistemit për të garantuar furnizim me energji elektrike në çdo kohë, përfshirë periudhat e ngarkesës maksimale ose mungesat e papritura të prodhimit. Përderisa mjaftueshmëria fokusohet në kapacitetin për të gjeneruar energji të mjaftueshme për të përbushur kërkesën, besueshmëria i referohet ruajtjes së furnizimit të qëndrueshëm dhe të pandërprerë me energji elektrike për konsumatorët. Siç u tha më herët, ngjarjet e fundit globale kanë dëshmuar rëndësinë e këtyre koncepteve dhe nevojën jo vetëm për t'i monitoruar goditjet e tilla, por edhe për të hartuar masa efektive, pasi rëniet e termocentraleve ose deficitet e prodhimit kanë ndikime të drejtpërdrejta ekonomike dhe sociale në jetën e njerëzve. Nga ana tjetër, edhe pse goditjet energjetike ndryshojnë sipas origjinës, intensitetit dhe kohëzgjatjes, të gjitha kanë potencial të cenojnë stabilitetin e sistemeve kombëtare energjetike dhe të gjenerojnë efekte ekonomike dhe sociale.

Literatura sugjeron se goditjet mund të kategorizohen sipas shpejtësisë së shfaqjes, shkallës dhe shtrirjes së ndërprerjes. Për shembull, goditjet mjedisore si ngjarjet ekstreme të motit, duke përfshirë valët e të nxehtit, stuhitë, përmytjet ose thatësitat, mund të dëmtojnë infrastrukturën energjetike, t'i ndërpresin linjat e transmisionit ose të detyrojnë mbylljen e termocentraleve. Goditjet gjeopolitike lindin nga konfliktet, embargot tregtare ose kufizimet në furnizimin me lëndë djegëse, të cilat mund t'i kufizojnë importet ose t'i rrisin çmimet, siç u demonstrua nga kriza e gazit në Evropë në vitin 2022. Avancimi i digjitalizimit të sistemeve të energjisë elektrike nënkupton që goditjet kibernetike janë gjithnjë e më të rëndësishme, duke i ekspozuar rrjetet dhe njësitë e prodhimit në rrezik të sulmeve kibernetike dhe manipulimit të të dhënave. Goditjet ekonomike ose ato të tregut, nga ana tjetër, burojnë nga rritjet e papritura të kërkesës, luhatjet e çmimeve ose vonesat teknologjike që dobësojnë fleksibilitetin e sistemit dhe kapacitetin e investimeve.

Viteve të fundit, institucionet globale dhe rajonale kanë theksuar gjithnjë e më shumë reziliencën energjetike si prioritet thelbësor të politikave.

Përvoja evropiane pas krizës së gazit në vitin 2022 tregoi se si goditjet e jashtme mund t'i ekspozojnë cënueshmëritë strukturore brenda tregjeve të ndërlidhura energjetike. Ndërsa mungesat e gazit dhe rritjet e çmimeve kanë prekur edhe vendet importuese edhe ato joimportuese, Komisioni Evropian dhe Agjencia Ndërkombëtare e Energjisë (IEA) kanë përgatitur masa emergjente dhe strategji afatgjate për të rritur reziliencën e sistemit dhe për të parandaluar kriza të ngjashme në të ardhmen. Në nivel të BE-së, u krijuan nismat si AggregateEU ose REPowerEU për të ulur varësinë nga importet e gazit duke diversifikuar furnizimet, rritur magazinimin e gazit dhe bashkëpunimin në blerjen e tij, si dhe duke promovuar eficiencën e energjisë dhe burimet e ripërtëritshme mes shteteve anëtare. Këto masa pasqyrojnë një reagim më të gjerë politikash për të forcuar mekanizmat e reagimit ndaj krizave, me fokus në sigurinë më të lartë të furnizimit me energji. Në nivel ndërkombëtar, shtetet kanë përshtatur qasjet sipas konteksteve të tyre specifike. Për shembull, në Gjermani është prioritet diversifikimi i importit të gazit dhe përsheptimi i integritetit të burimeve të ripërtëritshme, ndërsa Japonia ka rifilluar njësi të caktuara bërthamore për të balancuar efikasitetin e kostos dhe sigurinë energjetike. Këto përvoja tregojnë se nuk ekziston një model universal i reziliencës, pasi çdo shtet duhet t'i përshtatë reformat me burimet, infrastrukturën dhe kapacitetin institucional që ka. Megjithatë, të gjitha ndërlidhen në një mësim të përbashkët: rritja e mjaftueshmërisë së furnizimit dhe reziliencës energjetike kërkon kombinim burimesh energjetike të diversifikuara, tregje transparente dhe sisteme fleksibile të cilat janë në gjendje të rikuperohen shpejt kur ndodhin ndërprerjet.

Brenda këtij spektri, në sistemin energjetik të Kosovës, goditjet e mjaftueshmërisë ose mungesat e papritura të prodhimit — si ndërprerjet e papritura të operimit termocentraleve — paraqesin një formë veçanërisht kritike të ndërprerjes, pasi ndikojnë drejtpërdrejt në aftësinë e sistemit për ta përmbushur kërkesën për energji elektrike. Funkionimi i sektorit të energjisë elektrike mbetet shumë i varur nga operimi i blloqeve të vjetruara me qymyr (Kosova A dhe B), duke e bërë sistemin veçanërisht të ndjeshëm ndaj goditjeve të tilla. Nëse dështojnë këto blloqe, sidomos gjatë periudhave kritike të çmimeve të larta rajonale të energjisë elektrike ose konsumit të lartë, vendi duhet të mbështetet në importe të shtrenjta ose të aplikojë ndërprerje të furnizimit. Figura 1 paraqet prodhimin neto (shtyllat me ngjyrë kafe), funksionimin e prodhimit nga qymyri (vija me ngjyrë portokalli) dhe konsumin e energjisë elektrike (shtyllat e kaltra) ndërmjet viteve 2022 dhe 2025. Sezoni dimëror mbetet veçanërisht sfidues, meqë vendi shpeshherë përballlet me deficit energjetik kur konsumi rritet si pasojë e nevojës për ngrohje, ndërsa kapaciteti dhe prodhimi vendor mbeten të kufizuara. Kjo ndodh edhe pse termocentralet me qymyr zakonisht operojnë në nivele më të larta gjatë dimrit krahasuar me verën, siç tregohet në Figurën 1, ndërsa mirëmbajtja zakonisht kryhet gjatë muajve të verës kur konsumi është më i ulët.

Në përgjithësi, sistemi i energjisë elektrike mbetet i ndikuar nga disponueshmëria e blloqeve Kosova A dhe B, prandaj dhe është i cënueshëm

ndaj ndërprerjeve të termocentraleve me qymyr. Për shembull, në prill të vitit 2025 është regjistruar një nivel i dukshëm deficiti i lidhur me disponueshmërinë më të ulët të termocentraleve me qymyr (vija portokalli), krahasuar me vitet e mëparshme (p.sh. 2022 dhe 2024), kur Kosova zakonisht eksporton. Prodhimi i kufizuar vendor ka implikime më të gjera, pasi rrit varësinë nga importet dhe ekspozon sistemin ndaj një rreziku më të lartë të ndërprerjeve të furnizimit, veçanërisht gjatë periudhave me çmime të larta rajonale të energjisë elektrike. Për më tepër, viteve të fundit kjo cenueshmëri është bërë më e theksuar si pasojë e kapaciteteve të kufizuara prodhuese të kombinuara me rritjen e konsumit të brendshëm të energjisë elektrike, pjesërisht e nxitur nga trendet e elektrifikimit.




Figura 1. Trendi i përgjithshëm i sektorit të energjisë elektrike në Kosovë (2022–2025) i prodhimit neto (vjollce), faktorit të kapacitetit të termocentraleve (kaltër) dhe konsumit sipas muajve të vitit (boshti X). Të dhënat janë marrë nga ENTSO-e dhe nga llogaritjet vetanake.

Sipas klasifikimit të OECD-së (shih Tabelën 1), këto ngjarje përbëjnë goditje kovariate, pasi ndodhin papritur, kanë ndikime të gjera dhe ndërpresin sistemin në nivel shteti. Kjo rezulton në pasoja që shkojnë përtej dështimeve teknike, duke ndikuar në produktivitetin kombëtar, shërbimet publike dhe mirëqenien e familjeve. Si rrjedhojë, projektimi i reziliencës ndaj këtyre goditjeve kërkon veprim të koordinuar në dimensione teknike, institucionale dhe rregullative, duke siguruar që sistemet energjetike të mund të përthithin, të përshtaten dhe të rikuperohen në mënyrë efektive kur ndodhin ndërprerjet. Për më tepër, kapacitetet e vjetruara të prodhimit vendor dhe investimet e kufizuara në kapacitete të reja, në kombinim me

rritjen e konsumit të energjisë elektrike gjatë gjithë vitit, e rrisin peshën e kësaj goditjeje dhe përbëjnë stresor afatgjatë.

Dokumentet strategjike, përfshirë Strategjinë e Energjisë 2022–2031 dhe Planin Kombëtar të Energjisë dhe Klimës (PKEK), i njohin këto sfida dhe parashohin reforma që synojnë forcimin e reziliencës së sistemit. Masat e planifikuara përfshijnë rehabilitimin e blloqeve Kosova A dhe Kosova B, investime në kapacitete të reja prodhuese, reduktimin e humbjeve teknike dhe komerciale, rritjen e fleksibilitetit të sistemit dhe modernizimin e rrjeteve të transmisionit dhe shpërndarjes. Megjithëse këto reforma përcaktojnë një drejtim të qartë për modernizim dhe rritje të mjaftueshmërisë së sistemit, ato janë afatgjata, dhe efektiviteti i reziliencës së Kosovës ende varet nga zbatimi i tyre i suksesshëm. Në afat të shkurtër, sistemi vazhdon të përballet me rrezikun e mungesave të papritura të prodhimit, të cilat sjellin pasoja serioze socio-ekonomike. Prandaj, goditjet e mjaftueshmërisë mbeten aspekt thelbësor për funksionimin e mirë jo vetëm të sistemit të energjisë elektrike, por edhe të sektorëve të tjerë. Duhet theksuar se goditja e mjaftueshmërisë e trajtuar në këtë artikull përkufizohet si ndërprerje e papritur e termocentraleve ekzistuese dhe dallon nga mjaftueshmëria e përgjithshme e sistemit, e cila ka të bëjë me vlerësimin afatgjatë të prodhimit dhe konsumit.




Figura 2: Përmbledhje e goditjes së mjaftueshmërisë së prodhimit dhe lidhjet e saj me goditje/ndikime të tjera (Burimi: Krijimi i Autorëve).

Kuadri rregullativ

Kuadri ekzistues rregullativ i Kosovës për sigurimin e mjaftueshmërisë së prodhimit dhe menaxhimin e dështimeve të termocentraleve përbëhet nga ligje, strategji kombëtare dhe dokumente planifikimi. Për ta analizuar këtë goditje, i kemi shqyrtuar dokumentet kyçe strategjike që rregullojnë funksionimin e duhur të sektorit dhe sigurojnë furnizim të besueshëm dhe të vazhdueshëm me energji. Ky hap është thelbësor, pasi kuptimi i kuadrit aktual na lejon t'i identifikojmë boshllëqet, të vlerësojmë kornizën rregulative sipas metodologjisë 4R dhe t'i qartësojmë fushat që kërkojnë përmirësim. Megjithëse disa nga dokumentet, veçanërisht ligjet, janë hartuar para goditjeve të fundit të furnizimit, ato përfshijnë përkufizime të sistemit institucional që formëson kapacitetin e vendit për t'i parashikuar mungesat dhe për ta ruajtur sigurinë e furnizimit me energji elektrike. Sfidë kyçe është se ky kuadër është akoma në tranzicion: disa komponentë janë të fortë në letër, ndërsa të tjerët kanë mbështetje të lartë në investime të ardhshme, projekte të nxitura nga donatorët ose mekanizma rajonalë. Vlerësimi i qëndrueshmërisë afatgjate të këtij kuadri rregullativ identifikon zbrazëtira institucionale, por edhe mundësi për të përmirësuar reziliencën në sektorin e energjisë elektrike.

Megjithëse Kushtetuta e Republikës së Kosovës nuk e rregullon shprehimisht prodhimin e energjisë elektrike apo sigurinë e furnizimit, disa nene tregojnë në mënyrë të tërthortë se shteti është përgjegjës për menaxhimin e mungesave të prodhimit dhe rënies së termocentraleve. Dispozitat kushtetuese mbi zhvillimin e qëndrueshëm, përdorimin racional të burimeve natyrore dhe qasjen në infrastrukturë dhe shërbime publike thelbësore krijojnë bazën për planifikimin afatgjatë të burimeve energjetike dhe pritshmërinë për furnizim të besueshëm me energji elektrike për qytetarët. Nene të tjera theksojnë qeverisjen e mirë, mbrojtjen e mirëqenies së qytetarëve dhe pavarësinë e organeve rregullatore, të cilat së bashku përputhen me mandatin e institucioneve si Zyra e Rregullatorit për Energji, e cila mbikëqyrë sigurinë e furnizimit, funksionimin e rrjetit dhe reagimin ndaj krizave. Për trajtimin e kërcënimeve ndaj mjaftueshmërisë së prodhimit dhe dështimeve të termocentraleve, legjislacioni dhe planet energjetike të Kosovës duhet të funksionojnë brenda kornizës më të lartë të përcaktuar nga këto parime kushtetuese.

Ligji për Energjinë përcakton kuadrin bazik ligjor për sektorin e energjisë në Kosovë. Ai përcakton institucionet kryesore përgjegjëse për qeverisjen sektoriale dhe vendos parimet e përgjithshme për sigurimin e sigurisë së furnizimit. Ligji kërkon që Strategjia e Energjisë t'i identifikojë sfidat dhe goditjet e mundshme me të cilat mund të përballë sektori, ta ruajë balancën ndërmjet ofertës dhe kërkesës, të promovojë diversifikimin e buri-

meve energjetike dhe të sigurojë vazhdimësinë e furnizimit me energji për konsumatorët. Gjithashtu, ligji thekson rëndësinë e bashkëpunimit rajonal dhe harmonizimit me politikat energjetike të BE-së. Për më tepër, ligji inkurajon investime në infrastrukturë energjetike dhe në burime të ripërtëritshme të energjisë për të mbështetur qëndrueshmërinë dhe reziliencën afatgjatë. Në rastet e ngjarjeve të jashtëzakonshme ose emergjencave, të përcaktuara me Kushtetutë ose nga Qeveria, ligji autorizon qeverinë të miratojë masa emergjente energjetike, përfshirë kufizime të furnizimit ose detyrime të posaçme për ndërmarrjet energjetike.

Ligji për Energjinë Elektrike vendos bazën ligjore dhe përgjegjësitë për prodhuesit, Operatorin e Sistemit të Transmisionit dhe Shpërndarjes, si dhe Operatorin e Tregut, si mjet për garantimin e sigurisë së furnizimit, reziliencës ndaj goditjeve të jashtme dhe të brendshme, dhe mbrojtjen e konsumatorit. Gjithashtu, ai nënvizon rëndësinë e mbrojtjes së mjedisit dhe përdorimit eficient të energjisë elektrike. Sipas ligjit, siguria e furnizimit përkufizohet si kapaciteti i sistemit për të përbushur kërkesën e konsumatorëve në mënyrë të vazhdueshme. Operatori i Sistemit të Transmisionit (KOSTT) përcaktohet si autoriteti përgjegjës për ruajtjen e sigurisë operative të rrjetit, menaxhimin e balancimit dhe rregullimit të frekuencës, si dhe sigurimin e kapacitetit të mjaftueshëm rezervë. Ai gjithashtu përfaqëson Kosovën në ENTSO-E dhe merr pjesë në mekanizma rajonale që forcojnë reziliencën ndaj goditjeve. Operatori i Tregut dhe Operatori i Sistemit të Transmisionit ndajnë përgjegjësi për tregjet balancuese dhe sigurimin e stabilitetit të furnizimit gjatë luhatjeve të sistemit.

Nga ana tjetër, Ligji për Eficiencën e Energjisë përcakton kuadrin ligjor për përmirësimin e eficiencës energjetike në të gjitha hallkat e zinxhirit energjetik. Siç u theksua më sipër, intensiteti energjetik i Kosovës është i lartë, prandaj objektiv kyç është reduktimi i tij dhe zbutja e ndikimeve mjedisore. Përmirësimi i eficiencës gjithashtu ulë kërkesën totale, duke reduktuar varësinë nga importet dhe duke zvogëluar cenusshmërinë ndaj goditjeve të jashtme, përfshirë rritjet globale të çmimeve të energjisë. Ligji kërkon planifikim të strukturuar në nivel kombëtar dhe komunal përmes Planeve të Veprimit të bazuara në evidencë. Gjithashtu, ligji themelon Fondin e Kosovës për Eficiencë të Energjisë (FKEE), një entitet i pavarur dhe autonom që mbështet Qeverinë e Kosovës në zbatimin e masave të synuara të eficiencës. Përveç kësaj, Ligji promovon eficiencë më të madhe

“Sfidë kyçe është se ky kuadër është akoma në tranzicion: disa komponentë janë të fortë në letër, ndërsa të tjerët kanë mbështetje të lartë në investime të ardhshme, projekte të nxitura nga donatorët ose mekanizma rajonalë.”

të sistemit duke inkurajuar përmirësime kosto-efektive në rrjetet energjetike. Ai gjithashtu kërkon fushata ndërgjegjësimi për t'i informuar konsumatorët mbi përdorimin e energjisë, kostot dhe masat praktike të efijencës që mund t'i aplikojnë në familjet e tyre.

Fokusi i Ligjit për Rregullatorin e Energjisë është kompetencat, detyrat dhe funksionet e Zyrës së Rregullatorit për Energji (ZRRE), që përfshijnë licencimin, certifikimin e operatorëve të transmisionit, rregullimin e tarifave dhe monitorimin e tregut. Ai gjithashtu ngarkon ZRRE-në me monitorimin dhe forcimin e sigurisë së furnizimit me energji elektrike dhe për të mbikëqyrur planin dhjetëvjeçar të zhvillimit të Operatorit të Sistemit të Transmisionit, për të siguruar investime të mjaftueshme në infrastrukturë të re dhe kapacitet furnizimi. Ligji autorizon ZRRE-në të vendosë detyrime të shërbimit publik për furnizuesit dhe t'i rregullojë çmimet për konsumatorët si masa mbrojtëse të përkohshme gjatë ngjarjeve të jashtëzakonshme, duke ndihmuar në ruajtjen e vazhdimësisë së furnizimit. Mandati i tij gjithashtu përfshin mbrojtjen e konsumatorëve të cenueshëm, garantimin e së drejtës së klientëve për t'u lidhur me sistemin energjetik dhe për të pranuar energji elektrike, si dhe sigurimin që konsumatorëve dhe operatorëve të licencuar u garantohet mbrojtje përmes procedurave të qarta për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve.

Strategjia e Energjisë paraqet vizionin afatgjatë të Kosovës për sistemin energjetik. Kriza e viteve 2021–2022 ekspozoi disa cenueshmëri, përfshirë varësinë nga termocentralet e vjetruara me linjit, pjesëmarrjen e kufizuar të burimeve të ripërtëritshme dhe varësinë e lartë nga importet, veçanërisht gjatë sezonit dimëror. Ndonëse Kosova nuk është importuese direkte e gazit, ajo u ndikua nga efekti i zinxhirit të vlerës i rritjes së çmimeve të gazit në të gjitha tregjet evropiane të energjisë elektrike, gjë që u shndërrua në kosto më të larta të importeve. Strategjia gjithashtu nënvizon përdorimin joeficient të energjisë në Kosovë, me intensitet energjetik dukshëm mbi mesataren e BE-së. Për të forcuar reziliencën, ajo parashikon masa si zgjerimi i kapaciteteve të energjisë së ripërtëritshme për zëvendësimin gradual të linjtit, rinovimi i blloqeve termike Kosova A dhe Kosova B, promovimi i zgjidhjeve efijente të ngrohjes, forcimi i bashkëpunimit me vendet fqinje si Shqipëria, si dhe thellimi i integritetit në rrjetet evropiane të energjisë për t'i menaxhuar goditjet e ofertës dhe kërkesës. Gjithashtu, ajo thekson mbështetjen e ekonomive familjare në përballimin e faturave të larta të energjisë, si dhe në investimet për masa të efijencës.

Ngjashëm me Strategjinë e Energjisë së Kosovës, Plani Kombëtar i Energjisë dhe Klimës (PKEK) nënvizon sfidat e sistemit energjetik të Kosovës, veçanërisht gjatë stinëve me kërkesë të lartë për energji elektrike, gjegjësisht dimrit, për shkak të termocentraleve të vjetruara me linjit, humbjeve të larta në rrjet dhe varësisë nga importet gjatë kërkesës në orë të pikut. Ai përcakton prioritetet për forcimin e reziliencës, si rehabilitimi i blloqeve A dhe Kosova B për të garantuar operueshmërinë dhe besueshmërinë e kapaciteteve ekzistuese, ulja e varësisë nga importet përmes diversifikimit të burimeve energjetike dhe përmirësimi i sigurisë kibernetike në sektorin energjetik. Këto objektiva synohen të arrihen përmes zgjerimit të energjisë së ripërtëritshme,

investimeve në ruajtje me bateri, ngrohje qendrore diellore dhe modernizimit të sistemeve të ngrohjes urbane, në përputhje me strategjinë energjetike. Integrimi në tregun e BE-së dhe bashkëpunimi me shtetet rajonale shihen gjithashtu si element kyç për zbutjen e pasojave të goditjeve në furnizimin me energji. Për më tepër, përmenden masa stimuluese për familjet që të investojnë në përdorim eficient të energjisë dhe skema të targetuara të mbështetjes për t'i mbrojtur konsumatorët e cenueshëm. Vizioni i këtij plani është ndërtimi i një sistemi energjetik të qëndrueshëm dhe rezilient ndaj goditjeve të jashtme.

Strategjia dhe Plani Kombëtar i Zhvillimit përcakton vizionin afatgjatë të Kosovës për arritjen e zhvillimit ekonomik të qëndrueshëm, ku sektori i energjisë identifikohet si shtyllë kyçe e këtij qëllimi. Strategjia fokusohet në përmirësimin e sigurisë energjetike, qëndrueshmërisë, përballueshmërisë, integritimit në tregjet energjetike rajonale dhe pan-evropiane, rritjen e burimeve të ripërtëritshme në miksin energjetik dhe promovimin e eficiencës së energjisë. Gjithashtu, ajo njeht sfidat kryesore të sektorit, përfshirë sistemin dhe infrastrukturën e vjetruar të energjisë elektrike, varësinë e vazhdueshme nga termocentralet me linjit, varësinë e lartë nga importet — veçanërisht në muajt e dimrit — dhe përdorimin joefikas të energjisë, të cilat kontribuojnë në paqëndrueshmëri çmimesh dhe presion mbi përballueshmërinë. Përparimi në këto fusha do të matet përmes disa treguesve, si ulja e përqindjes së kostove të energjisë në të ardhurat totale të familjeve nga 12.46% në 8% deri në vitin 2030, ulja e humbjeve komerciale nga 3.38% në 0%, ndërsa humbjet në transimion pritet të mbeten në 1.75%. Kosova aktualisht përdor vetëm rreth një të katërtën e kapacitetit të saj të disponueshëm ndërkufitar të transimionit; Strategjia synon rritjen e tij në rreth 40% deri në vitin 2026 dhe harmonizimin me minimumin e BE-së prej 70% deri në vitin 2030. Për sa i përket integritimit të tregut, plani parasheh integrim të plotë me Shqipërinë deri në vitin 2026 dhe synon pjesëmarrje në zonën pan-evropiane të tregut deri në vitin 2030. Për eficiencën e energjisë dhe energjinë e pastër, objektivat përfshijnë rritjen e përqindjes së burimeve të ripërtëritshme në konsumin final bruto të energjisë nga 24.4% në 32% deri në vitin 2030, rritjen e kursimeve të parashikuara të energjisë nga 2.7 kToe në 217.6 kToe dhe uljen e intensitetit energjetik nga 467.2 toe/milion € në 150–220 toe/milion € deri në vitin 2030.

Në përgjithësi, kuadri rregullativ i Kosovës ofron një bazë të strukturuar për forcimin e sigurisë energjetike, por efektiviteti i saj ende varet nga zhvillimi i kapaciteteve të reja prodhuese, modernizimi i infrastrukturës së vjetruar, reduktimi i varësisë nga importet dhe përsheptimi i integritimit me tregjet rajonale dhe evropiane. Megjithatë ligjet, strategjitë dhe planet e zhvillimit përcaktojnë objektiva të qarta afatgjate, rezilienca praktike ndaj mungesave të prodhimit dhe dështimeve të termocentraleve mbetet e kufizuar pa investime në kohë, pa modernizim apo kapacitete operative rezervë.

Zbatimi i Kornizës Analitike të Politikave

Pas identifikimit të dokumenteve strategjike kyçe që kanë të bëjnë me këtë goditje, do të aplikojmë vlerësimin e 4R-ve të përshkruar në Kapitullin 2. Ndonëse rezilienca shpeshherë konsiderohet si koncept cilësor, kemi realizuar një vlerësim sasior të shtatë dokumenteve të përzgjedhura — katër ligje dhe tri strategji/plane — për ta matur reziliencën e Kosovës ndaj sfidave të mjaftueshmërisë së prodhimit. Në këtë kapitull paraqesim notat vlerësuese dhe arsyetimin për secilin dokument sipas katër dimensioneve të reziliencës. Qëllimi është të kuptohet se në cilat aspekte kuadri aktual performon mirë dhe ku ka ende dobësi, në mënyrë që të identifikohen qartas fushat që kërkojnë përmirësim dhe të ulet cenueshmëria e përgjithshme e sistemit.

Ligji nr. 05/L-081 për Energjinë




Figura 3: Vlerësimi sipas kornizës së 4R-ve të Ligjit për energjinë nr. 05/L-081 (Burimi: Krijim i Autorëve)

Ligji për Energjinë përbën bazën e kuadrit të qeverisjes energjetike të Kosovës, veçanërisht në sigurimin e sigurisë së furnizimit dhe stabilitetit afatgjatë të sistemit. Megjithatë, kur vlerësohet kundrejt goditjeve si pamjaftueshmëria e prodhimit ose dështimet e termocentraleve, ligji demonstroi nivel të përzier rezilience (vlerësimi i përgjithshëm 75%). Qëndrueshmëria e tij është e lartë (notë 3), pasi përcakton mekanizma të qartë ligjorë dhe institucionale për mjaftueshmërinë e sistemit, përfshirë Strategjinë e Energjisë, Programin e Zbatimit të Strategjisë, Bilancet e Energjisë dhe planet e de-

tyrueshme 10-vjeçare të zhvillimit për operatorët e transmisionit dhe shpërndarjes. Këto instrumente krijojnë një bazë të fortë për planifikim dhe mbikëqyrje për të parandaluar ndërprerjet e prodhimit në afat të shkurtër dhe të gjatë.

Megjithatë, kapacitetet rezervë janë më të kufizuara (notë 2). Ligji nuk përfshin metoda gjithëpërfshirëse rezervë për prodhim alternativ ose masa emergjente ndërkufitare, pavarësisht theksit të tij në diversifikimin e energjisë, kapacitetet rezervë dhe integrimin e burimeve të ripërtëritshme. Zbatimi i redundancës mbështetet kryesisht në akte nënligjore, investime dhe koordinim më të gjerë sektorial. Ligji promovon koordinim shumëpalësh ndërmjet Ministrisë, ZRRE-së, operatorëve të sistemit, komunave dhe investitorëve privatë, por mungesa e mekanizmave të qartë për financim emergjent ose mobilizim burimesh gjatë ndërprerjeve të paplanifikuara bën që kapaciteti për mobilizim të burimeve të jetë mesatar (notë 1).

Shpejtësia (e reagimit) vlerësohet lartë (notë 3), meqë neni 25 përcakton kuadrin e qartë të reagimit emergjent me procedura me afate kohore, që mundësojnë Qeverinë të vendosë masa të përkohshme, ta kufizojë furnizimin dhe t'i aktivizojë protokollet e krizës me shpejtësi. Në raste krizash të mëdha të furnizimit, këto masa mundësojnë veprim institucional relativisht të shpejtë.

Në përgjithësi, rezilienca e sektorit ndaj goditjeve që kanë të bëjnë me prodhimin është jokonsistente, ndonëse Ligji për energjinë ofron një bazë institucionale të plotë (p.sh. përmes planifikimit afatgjatë të mjaftueshmërisë dhe bilanceve energjetike). Megjithëse ekzistojnë procedura të forta emergjente dhe planifikuese, redundanca dhe mobilizimi adaptiv i burimeve janë ende të kufizuara, gjë që sugjeron nevojën për masa shtesë për t'i zbutur plotësisht rreziqet e dështimeve të termocentraleve dhe mungesave të furnizimit.

Ligji për Energjinë Elektrike nr. 05/L-085




Figura 4: Vlerësimi sipas kornizës së 4R-ve të Ligjit për energji elektrike nr. 05/L-085 (Burimi: Krijim i Autorëve)

Ligji për energjinë elektrike përbën një kuadër rregullativ dhe teknik gjithëpërfshirës për sektorin elektroenergjetik të Kosovës, veçanërisht për furnizim të sigurt, të besueshëm dhe cilësor. Ligji demonstron reziliencë strukturore relativisht të konsiderueshme (vlerësim i përgjithshëm 75%) kur testohet kundrejt goditjeve si pamjaftueshmëria e prodhimit ose dështimet e termocentraleve.

Qëndrueshmëria e tij është vlerësuar si e fortë (notë 3), pasi ligji i përcakton qartas mekanizmat institucionalë, teknikë dhe ligjorë për ruajtjen e mjaftueshmërisë së sistemit, si dispozitat për detyrimet e prodhuesve, rezervat për lëndë djegëse dhe përgjegjësitë e Operatorit të Sistemit të Transmisionit (OST/KOSTT). Këto masa krijojnë bazë solide për menaxhimin e balancës energjetike, kapacitetin prodhues dhe sigurinë operative, në përputhje me standardet e tregut të energjisë elektrike të BE-së.

Kapacitetet rezervë janë në nivel mesatar (notë 2). Ligji nuk përcakton pragje specifike ose kërkesa të detajuara për depozitim/rezervat, por mandaton kapacitete rezervë, stoqe lëndë djegëse dhe diversifikim burimesh, përfshirë kogjenerimin dhe integrimin e burimeve të ripërtëritshme. Redundanca mbetet kryesisht konceptuale dhe ligjore, ndërsa zbatimi real varet nga aktet nënligjore dhe vendimet investuese; edhe pse ligji nënvizon rëndësinë e kapaciteteve rezervë dhe sistemeve mbështetëse, mungon një plan i plotë për instalimin dhe mbikëqyrjen e tyre. Ligji inkurajon bashkëpunim rajonal në kuadër të Komunitetit të Energjisë dhe lejon koordinim institucional ndërmjet OST-së, OSSH-së, Operatorit të Tregut dhe aktorëve të tjerë. Megjithatë, për shkak të mungesës së dispozitave të qarta për financim emergjent ose rialokim fleksibil financiar që do të mundësonte rikuperim të shpejtë gjatë dështimeve të mëdha të prodhimit, aftësia e mobilizimit të resurseve mbetet e kufizuar (notë 2).

Shpejtësia është mesatarisht e fortë (notë 2). Ligji kërkon që Kodi i Rrjetit të Transmisionit të përfshijë procedura për operimin normal dhe emergjent të sistemit, në mënyrë që OST të mund të reagojë shpejt ndaj disbalancave ose situatave të paparashikuara. Gjithashtu, kapaciteti i OST-së për të dislokuar burime, për t'i prioritetuar njësitë esenciale të prodhimit dhe për t'i aktivizuar ofertat balancuese mundëson veprim të shpejtë operacional; megjithatë efektiviteti në kohë reale kufizohet nga kapaciteti i dobët balancues i Kosovës, varësia nga importet dhe termocentralet e vjetruara.

Në përgjithësi, Ligji për energjinë elektrike përbën një kuadër të përcaktuar mirë dhe teknikisht i harmonizuar për ruajtjen e besueshmërisë së sistemit, por rezilienca e tij ndaj goditjeve të rënda të lidhura me prodhimin mbetet joadekuate. Ndërsa protokollet emergjente dhe qëndrueshmëria janë relativisht të forta, investimet e ardhshme, aktet nënligjore dhe përmirësimet e kapacitetit të sistemit luajnë rol kyç në redundancë dhe mobilizimin e burimeve specifike për kriza.

Ligji për Eficiencën e Energjisë nr. 06/L-079




Figura 5: Vlerësimi sipas kornizës së 4R-ve të Ligjit për eficiencën e energjisë nr. 06/L-079. (Burimi: Krijim i Autorëve)

Ligji për eficiencën e energjisë përbën një kuadër gjithëpërfshirës institucional dhe ligjor që synon forcimin e sistemit energjetik të Kosovës përmes uljes së presionit të kërkesës dhe përmirësimit të eficiencës, dy elemente që mbështesin në mënyrë indirekte mjaftueshmërinë e prodhimit dhe stabilitetin e furnizimit.

Qëndrueshmëria e tij është e lartë (notë 3), pasi mandaton objektiva shtetërore dhe lokale të eficiencës përmes Planeve Kombëtare të Veprimit për Eficiencë të Energjisë (PKVEE), promovon eficiencën në ngrohje, ftohje dhe transformim energjetik, si dhe krijon institucione kyçe si Fondi i Kosovës për Eficiencë të Energjisë (FKEE) dhe Agjencia e Kosovës për Eficiencë të En-

ergjisë (AKEE). Këta mekanizma institucionalizojnë planifikimin afatgjatë në anën e kërkesës, ulin ngarkesat në kohë të pikut dhe ndihmojnë në ruajtjen e balancës së sistemit gjatë periudhave të stresit në prodhim, duke përmirësuar në mënyrë indirekte besueshmërinë.

Kapacitetet rezervë janë mesatare (notë 2). Megjithatë ligji nuk synon krijimin e kapaciteteve të reja rezervë të prodhimit, të cilat çështje janë jashtë fushës së një ligji për eficiencën, ai kontribuon në kapacitetet rezervë duke ulur stresin e sistemit gjatë mungesave. Masat si përmirësimi i ngrohjes qendrore, kogjenerimi dhe reduktimi i kërkesës ndihmojnë në uljen e presionit mbi termocentralet kryesore, ndërsa kompanitë e shërbimeve energjetike (ESCO), nismat komunale dhe financimi alternativ (nenet 9–11) ofrojnë rrugë të shumta për uljen e konsumit kur sistemi është nën presion. Këto forma fleksibiliteti në anën e kërkesës mund të veprojnë si amortizues gjatë goditjeve, edhe pse Ligji nuk përfshin dispozita për prodhim rezervë. Kapaciteti i mobilizimit të resurseve është gjithashtu mesatar (notë 2). Ligji mobilizon institucione dhe financim përmes FKEE-së, mekanizëm ky qarkullues për projekte publike dhe private të eficiencës, dhe nenet 10–14 zgjerojnë gamën e aktorëve — përfshirë komunitat, bizneset dhe ESCO-të, që mund të zbatojnë masa efieciencie. Megjithatë, Ligji i mungojnë protokolle të qarta për rialokim emergjent ose burime rezervë financimi.

Shpejtësia është mesatarisht e fortë (notë 2). Ligji lehtëson adaptime më të shpejta të kërkesës gjatë mungesave përmes njehsorëve inteligjentë dhe sistemeve të përmirësuar të faturimit, të cilat rrisin ndërgjegjësimin situacional dhe mundësojnë reagime më të shpejta nga përdoruesit fundorë. Megjithatë, kjo shpejtësi mbetet indirekte dhe varet në masë të madhe nga përmirësimet strukturore afatgjata. Mbulesa e kufizuar me njehsorë inteligjentë, e kombinuar me mungesën e mjeteve emergjente të menjëhershme, vazhdon të kufizojë reagimin në kohë reale gjatë goditjeve të rënda të prodhimit.

Në përgjithësi, Ligji për eficiencën e energjisë mbështet besueshmërinë e sistemit kryesisht përmes reziliencës në anën e kërkesës; rezilienca e tij e përgjithshme është rreth 75%. Edhe pse qëndrueshmëria është e lartë dhe ofron kontribut domethënës në redundancë dhe fleksibilitet, ndikimi i tij gjatë goditjeve të rënda të prodhimit varet nga përmirësimet strukturore, digjitalizimi më i gjerë dhe zhvillimi i mekanizmave më të qartë të financimit emergjent dhe koordinimit. Për më tepër, megjithatë programet e eficiencës synojnë uljen e kërkesës së përgjithshme për energji, ato duhet të projektohen edhe për të reduktuar kërkesën në kohë të pikut të energjisë elektrike, ashtu që të mbështesin sistemin gjatë periudhave kritike (p.sh. ndërprerje të termocentraleve).




Figura 6 Vlerësimi sipas kornizës së 4R-ve të Ligjit për Ligjin për Rregullatorin e Energjisë nr. 05/L-084. (Burimi: Krijim i Autorëve)

Ligji për Rregullatorin e Energjisë përcakton kornizën institucionale, ligjore dhe rregullative që Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) përdor për të monitoruar vazhdimësinë e furnizimit, besueshmërinë operative dhe mjaftueshmërinë e sistemit.

Qëndrueshmëria është e lartë (notë 3), pasi ligji përcakton qartë mandatin e ZRRE-së për monitorimin dhe forcimin e sigurisë së furnizimit, mbikëqyrjen e investimeve në kapacitete prodhuese dhe ndërlidhëse, si dhe ruajtjen e stabilitetit operacional dhe ekonomik në të gjithë zinxhirin e energjisë elektrike. Legjislacioni ofron bazë të fortë institucionale për menaxhimin e rreziqeve të furnizimit dhe prodhimit përmes detyrave si miratimi i bilanceve vjetore të energjisë, planeve të investimeve, procedurave tarifore dhe mekanizmave të balancimit, si dhe përmes kompetencave të tij për licencim dhe zbatim.

Kapacitetet rezervë janë në nivel mesatar (notë 2). Përmes diversifikimit të tregut, integritit ndërkufitar dhe bashkëpunimit rregullativ rajonal, në mënyrë indirekte ligji rrit kapacitetin rezervë. Bashkëpunimi rajonal mund të ofrojë mbrojtje të jashtme gjatë mungesave të prodhimit vendor, ndërsa dispozitat për licencim, konkurrencë dhe hyrje të aktorëve të rinj në treg mundësojnë diversifikim pronësie dhe rritje kapacitetesh. Por kjo redundancë kryesisht mbështetet në dinamika të tregut, përmbushje të operatorit dhe rrjedha rajonale të energjisë në vend të sistemeve të dedikuara të rezervës, për arsye se në ligj nuk ka kërkesa të qarta për prodhim të rezervave fizike apo kapacitete të garantuara rezervë.

Kapaciteti i mobilizimit të resurseve është gjithashtu mesatar (notë 2). Ligji siguron fleksibilitet institucional duke e përcaktuar ZRRE-në si organizatë

autonome, financiarisht të vetëqëndrueshme dhe me menaxhim teknik të specializuar. ZRRE mund të modifikojë licenca, të nxjerrë akte nënligjore, të detyrojë investime dhe të penalizojë mospërbushje, për t'i mundësuar përshtatjen e masave rregullative ndaj sfidave të reja. Megjithatë, kufizimet praktike, si kapacitetet e kufizuara teknike dhe njerëzore dhe vonesat në koordinimin me operatorët e sistemit gjatë emergjencave, e reduktojnë aftësinë për mobilizim të shpejtë të burimeve në rast dështimesh të prodhimit.

Shpejtësia është më e dobët (notë 1). Ligji parashikon procedura për vendimmarrje të përshpejtuar, përfshirë afate të përcaktuara për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve dhe aftësinë e Bordit të ZRRE-së për të marrë vendime rregullative detyruese. Megjithatë, si ligj me natyrë juridike e rregullative, këto procedura marrin kohë dhe nuk janë hartuar për vendimmarrje të menjëhershme në situata emergjente operative. Si rrjedhojë, ndonëse përbën një bazë ligjore për veprim të shpejtë rregullativ, ligjit i mungojnë mekanizmat praktikë për vendosjen e shpejtë të masave operative ose menaxhimin e krizave gjatë ndërprerjeve të mëdha të prodhimit.

Në përgjithësi, Ligji për Rregullatorin e Energjisë përbën një kuadër të fortë institucional dhe rregullativ me reziliencë të përgjithshme rreth 67%, por kapacitete rezervë të kufizuara, vështirësitë në mobilizimin e resurseve dhe reagimi i ngadalshëm në kohë reale vazhdojnë të kufizojnë kapacitetin e tij për t'i përballuar goditjet e rënda që kanë të bëjnë me prodhimin.

Strategjia Kombëtare për Energji 2022 - 2031




Figura 7: Vlerësimi sipas Kornizës së 4R-ve për Strategjinë e Kombëtare të Energjisë të 2022 - 2031 (Burimi: Krijim i Autorëve)

Strategjia Kombëtare për Energji shfaq reziliencë të përgjithshme prej rreth 67%. Qëndrueshmëria është e lartë (notë 3), pasi adreson drejtpërdrejt mjaftueshmërinë e prodhimit, thekson dobësitë e lidhura me njësitë bazë të

vjetruara dhe përcakton veprime konkrete për garantimin e vazhdimësisë së furnizimit. Këto përfshijnë dekomisionimin e planifikuar të Kosovës A, reabilitimin e Kosovës B, diversifikimin e miksit të prodhimit dhe zgjerimin e kapaciteteve fleksibile dhe të ripërtëritshme. Duke kombinuar reforma strukturore me masa që përmirësojnë stabilitetin operacional gjatë ndërprerjeve të furnizimit ose dështimeve të termocentraleve, strategjia parashikon edhe përmirësimin e ndërlidhjeve ndërkufitare dhe rritjen e besueshmërisë së rrjeteve të transmisionit dhe shpërndarjes.

Kapacitetet rezervë janë mesatare (notë 2). Strategjia nxit kapacitete rezervë përmes diversifikimit, integritimit rajonal dhe investimeve në energji të ripërtëritshme dhe teknologji të magazinimit. Ajo vendos objektiva të matshme për zgjerimin e energjisë së ripërtëritshme (35–45% BRE deri në vitin 2031) dhe parashikon përdorim më të madh të balancimit ndërkufitar dhe shkëmbimeve të energjisë si mjete kontingjence kur prodhimi vendor është i pamjaftueshëm. Megjithatë, redundanca mbetet e varur nga investimet dhe zhvillimet rregullative të ardhshme, veçanërisht për sa i përket magazinimit, kapaciteteve rezervë dhe shfrytëzimit të plotë të ndërlidhjeve, duke e bërë redundancën praktike më pak të sigurt sesa synimi i saj strategjik.

Strategjia demonstroi aftësi mesatare të mobilizimit të resurseve (notë 2). Ajo tregon adaptueshmëri të konsiderueshme institucionale dhe financiare duke promovuar veprime të koordinuara ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë, KOSTT-it, Zyrës së Rregullatorit për Energji dhe programeve të investimeve të mbështetura nga donatorët. Theksohet mobilizimi i kapitalit privat dhe fondeve të BE-së për projekte të energjisë së ripërtëritshme dhe fleksibilitetit, ndërsa inkurajohet digjitalizimi dhe ngritja e kapaciteteve për përmirësimin e monitorimit dhe vendimmarrjes. Strategjia gjithashtu integron masa në anën e kërkesës përmes lidhjeve me Planin e Efiçencës së Energjisë dhe Klimës. Megjithatë, mobilizimi efektiv i burimeve kërkon koordinim të fortë ndërinstitucional dhe kapacitet institucional të qëndrueshëm, të cilat mbesin sfida në zhvillim.

Shpejtësia, megjithatë, mbetet e kufizuar (notë 1). Strategjia thekson modernizimin e rrjetit, monitorimin e sistemit në kohë reale dhe protokollet e menaxhimit emergjent, si përmirësimi i indikatorëve SAIDI/SAIFI dhe forcimi i sigurisë kibernetike, për të mundësuar zbulim dhe rikuperim më të shpejtë të sistemit gjatë ndërprerjeve ose mungesës së furnizimit. Megjithëse këta mekanizma janë të përcaktuar qartë, efektiviteti i tyre varet nga investime dhe përditësime rregullative të ardhshme që ende nuk janë zbatuar. Në praktikë, reagimi i shpejtë mbetet më shumë aspiratë se çështje operationale, pasi Kosova vazhdon të përballet me ndërprerje, veçanërisht gjatë periudhave me kërkesë të lartë (në dimër) si dhe gjatë rënieve të termocentraleve. Edhe pse Strategjia aplikon një kuadër për koordinim më të shpejtë, koha reale e reagimit mbetet e kufizuar nga këto kufizime themelore të sistemit.

Plani Kombëtar i Energjisë dhe Klimës (PKEK)




Figura 8: Vlerësimi sipas Kornizës së 4R-ve për Strategjinë e Kombëtare të Energjisë dhe Klimës (PKEK) (Burimi: Krijim i Autorëve)

Plani Kombëtar i Energjisë dhe Klimës mbështetet në Strategjinë e Energjisë dhe kombinon objektivat afatgjata me objektivat e Kosovës për vitin 2030, duke adresuar drejtpërdrejtë sigurinë e furnizimit dhe mjaftueshmërinë e sistemit. Qëndrueshmëria është e lartë (notë 3), pasi propozon masa konkrete për forcimin e reziliencës, përfshirë rehabilitimin e bllokun Kosova B dhe rikthimin e pjesshëm të bllokut Kosova A (PAM 43–44), së bashku me përmirësimin e sigurisë kibernetike, modernizimin e rrjetit dhe investimet në ruajtje me bateri. PKEK kërkon monitorim të vazhdueshëm të Deklaratës së Sigurisë së Furnizimit dhe përmirësim të parashikimit të balancës ndërmjet prodhimit dhe kërkesës, duke njohur njëkohësisht kufizimet e sistemit (blloqet e vjetruara me linjit, mungesën e kapacitetit rezervë dhe varësinë nga importet, veçanërisht në dimër). Së bashku, këto veprime forcojnë kapacitetin institucional të Kosovës për të parashikuar, parandaluar ose zbutur dështimet e prodhimit.

Kapacitetet rezervë janë mesatare (notë 2). PKEK mbështet rrugë të shumta rezervë përmes bashkimit të tregjeve rajonale, tregjeve të fleksibilitetit, integritit të burimeve të ripërtëritshme dhe magazinimit me bateri (PAM 47). Bashkimi i tregut me Shqipërinë (PAM 51) ofron opsione balancimi afatshkurtra, ndërsa burimet e ripërtëritshme të ndryshueshme diversifikojnë miksin e prodhimit. Megjithatë, kapacitetet rezervë mbeteten shumë të varura nga shkëmbimet rajonale dhe rehabilitimi i termocentraleve ekzistuese, pasi nuk pritet prodhim alternativ bazë në afat të shkurtër. Kapaciteti i mobilizimit të resurseve, nga ana tjetër, është i fortë (notë 3). PKEK demonstron adaptueshmëri të lartë institucionale dhe financiare përmes koordinimit të ZRRE-së, KOSTT-it dhe disa ministri me partnerë ndërkombëtarë si GIZ, German Energy Transition (GET), Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BER-

ZH) dhe Millennium Challenge Corporation (MCC). Ai paraqet mekanizma për mobilizimin e investimeve përmes projekteve strategjike dhe programeve të financuara nga BE-ja ose donatorët, ndërsa integron nisma për ngritjen e kapaciteteve (PAM 60–61) që forcojnë kapitalin njerëzor.

Shpejtësia është mesatare (notë 2). PKEK ende mbështetet në masë të madhe në investime infrastrukturore të ardhshme si automatizimi i rrjetit dhe magazinimi me bateri, megjithëse përfshin mekanizma proceduralë për fleksibilitet operacional dhe menaxhim më të mirë të krizave, veçanërisht përmes balancimit të bazuar në treg përmes bursës shqiptare të energjisë (ALPEX) dhe monitorimit të shtuar digjital. Kapacitetet e kufizuara vendore rezervë dhe varësia nga partnerët rajonalë nënkuptojnë se reagimi gjatë periudhave me deficit mbetet i kufizuar.

Në përgjithësi, PKEK përbën një kuadër të detajuar dhe të koordinuar që forcon mjaftueshmërinë strukturore dhe kapacitetet institucionale për mobilizim burimesh (reziliencë e përgjithshme rreth 83%). Megjithatë, kapacitetet rezervë dhe aftësia e reagimit të shpejtë mbeten të varura nga investimet, duke kufizuar aftësinë e Kosovës për të reaguar në mënyrë autonome ndaj goditjeve të papritura të prodhimit, ndërsa zgjidhja e mbetur në praktikë mbetet mbështetja në importe gjatë periudhave me deficit.

Strategjia dhe Plani Kombëtar për Zhvillim (SPKZH) 2030




Figura 9: Vlerësimi sipas kornizës së 4R-ve të Strategjisë dhe Planit Kombëtar për Zhvillim 2030 (SPKZH) (Burimi: Krijim i Autorëve)

SPKZH 2030 përforcon mjaftueshmërinë e prodhimit dhe sigurinë e furnizimit kryesisht përmes Objektivit 2.1 (Përmirësimi i sigurisë së energjisë, qëndrueshmërisë dhe përballueshmërisë) dhe Objektivit 2.2 (Integrimi në tregjet energjetike rajonale dhe pan-evropiane).

Qëndrueshmëria është e lartë (notë 3), pasi Strategjia vendos objektiva të matshme që promovojnë drejtpërdrejt sigurinë e furnizimit, si ulja e pjesës së kostove të energjisë në buxhetin e ekonomive familjare, reduktimi i humbjeve teknike dhe përmbushja e pragut të BE-së prej 70% të shfrytëzimit të ndërlidhjeve. Objektivat plotësuese, si 3.3 (rritja e përpjesës së burimeve të ripërtëritshme) dhe 3.4 (eficienca e energjisë), ndihmojnë gjithashtu në uljen e varësisë nga termocentralet e vjetruara dhe balancimin e kërkesës, duke i dhënë Strategjisë një bazë koherente për stabilitet afatgjatë të sistemit gjatë rënieve të mundshme të termocentraleve ose goditjeve të jashtme.

Kapacitetet rezervë janë mesatare (notë 2). Megjithëse SPKZH nuk specifikon prodhimin rezervë ose kapacitetet rezervë, ajo krijon kanale alternative furnizimi në rast ndërprerjesh vendore përmes rritjes së integritit rajonal dhe kapaciteteve të energjisë së ripërtëritshme. Aftësia e mobilizimit të resurseve është e lartë (notë 3), pasi Strategjia mobilizon shumë institucione dhe harmonizohet me Strategjinë e Energjisë dhe PKEK, duke shfrytëzuar mbështetjen e donatorëve dhe të BE-së për të mundësuar fleksibilitet dhe investime. Shpejtësia, megjithatë, mbetet e kufizuar (notë 1). Ndërsa SPKZH promovon rrjete inteligjente, monitorim dhe përmirësim të indikatorëve SAIDI/SAIFI për të përshpejtuar reagimin në të ardhmen, këta mekanizma varen nga investimet e ardhshme, që nënkupton se gatishmëria emergjente në kohë reale mbetet e dobët.

Në përgjithësi, SPKZH 2030 tregon reziliencë relativisht të fortë (rezultat i përgjithshëm rreth 75%). Përderisa objektivat strategjike dhe mekanizmat e koordinimit ofrojnë bazë solide për siguri energjetike në afat të gjatë, dobësitë në kapacitete rezervë dhe reagim të shpejtë kufizojnë aftësinë e tij për t'i përballuar në praktikë goditjet e papritura të prodhimit.

Diskutimi i gjetjeve

Pas përfundimit të vlerësimit sipas kornizës së 4R-ve të kuadrit rregullativ të Kosovës në kontekst të mjaftueshmërisë së prodhimit, rezultatet tregojnë se legjislati aktual demonstroi reziliencë mesatare, me rezultat të përgjithshëm rreth 74%. Ndërsa kuadri rregullativ shfaq nivel të caktuar përgatitjeje dhe kapacitet reagues, që do të thotë se Kosova nuk është shumë e cenueshme ndaj një goditjeje të tillë, megjithatë mbesin zbrazëtira të rëndësishme. Gjetjet tona zbulojnë dobësi strukturore në dokumentet e vlerësuara që kufizojnë aftësinë e autoriteteve për t'iu përgjigjur në mënyrë efektive goditjeve energjetike, të cilat vazhdojnë të përbëjnë rreziqe të vazhdueshme dhe në rritje për vendin.

Tabela 5: Rezultati total i politikave të vlerësuara

#	Politikat	Vlerësimi	Pikët maksimale
1	Ligji për Energjinë	9	84
2	Ligji për Eficiencën e Energjisë	9	
3	Ligji për Energjinë Elektrike	9	
4	Ligji për Rregullatorin e Energjisë	8	
5	Strategjia e Energjisë e Republikës së Kosovës (2022 - 2031)	8	
6	Plani Kombëtar i Energjisë dhe Klimës (2025- 2030)	10	
7	Strategjia dhe plani kombëtar për zhvillim 2030	9	
Gjithsej		62	73,8%

Për sa i përket qëndrueshmërisë, vlerësimi tregon se kuadri rregullativ është përgjithësisht i fortë, ku shumica e dokumenteve marrin notë 3. Legjislati përcakton qartas rolin e secilit autoritet, shumë prej të cilëve funksionojnë si organizata të pavarura dhe autonome, për të siguruar vazhdimësinë e furnizimit. Gjithashtu, ai kërkon planifikim afatgjatë, përfshirë rehabilitimin e blloqeve ekzistuese të prodhimit (p.sh. Kosova A), dhe përcakton objektiva të matshme si kapacitetet e burimeve të ripërtëritshme, diversifikimin e burimeve energjetike dhe përmirësimin e indikatorëve të ndërprerjes (SAIDI/SAIFI). Megjithatë, Kosova mbetet me varësi të lartë në termocentralet e vjetruara me linjit, funksionimi i të cilave nuk është i besueshëm (ndërprerje të shpeshta), ka kapacitete të kufizuara prodhuese vendore dhe varësi të lartë nga importet — veçanërisht gjatë krizës në kohë të pikut. Për t'u përballur me këto sfida, sistemi kërkon investime të vazhdueshme për t'i

përmbushur objektivat e strategjive dhe planeve qeveritare. Prandaj, kuadri rregullativ i Kosovës është strukturalisht i qëndrueshëm, por qëndrueshmëria praktike e tij mbetet e kufizuar nga infrastruktura e vjetruar, rezervat e kufizuara dhe varësia nga investimet e ardhshme.

Për sa i përket kapaciteteve rezervë, kuadri rregullativ performon në nivel mesatar (notë 2). Legjislacioni dhe strategjitë inkurajojnë integrim më të fortë rajonal, veçanërisht përmes bashkimit të tregut me Shqipërinë dhe përdorimit më të madh të shkëmbimeve ndërkufitare. Megjithatë, ndonëse ky element varet edhe nga vullneti politik në nivel rajonal, diversifikimi i miksit energjetik, zgjerimi i prodhimit nga burimet e ripërtëritshme dhe zhvillimi i burimeve të fleksibilitetit (p.sh. ruajtja me bateri) mund të rrisin më tej kapacitetet rezervë. Në rast se sistemi përballet me ndërprerje të papritur të centralit vendor të prodhimit vendas, këta komponentë sigurojnë qëndrueshmëri në sigurimin e furnizimit me energji. Megjithatë, kapacitetet rezervë aktual mbeteten kryesisht konceptuale dhe e orientuar nga politikat, jo plotësisht operacionale, veçanërisht për shkak të kapaciteteve të kufizuara vendore. Mungesa e rezervave fizike të përcaktuara qartë ose planeve konkrete për prodhim emergjent kufizon ndjeshëm aftësinë e sistemit për tu përballë me goditje të papritura.

Për sa i përket aftësisë së mobilizimit të resurseve, kuadri rregullativ shfaq nivel mesatar deri në nivel të fortë, pasi shumë dokumente marrin notë 2 ose 3. Kjo lidhet kryesisht me krijimin dhe përcaktimin e qartë të detyrave të institucioneve të pavarura dhe autonome si ZRRE, KOSTT, AKEE dhe FKEE. Bashkëpunimi me një gamë të gjerë aktorësh, duke i përfshirë ministritë, komunat dhe agjencitë ndërkombëtare të zhvillimit, i mundëson sektorit të forcojë reziliencën dhe të mobilizojë resurset ndërsektoriale, sipas nevojës. Megjithëse mekanizmat e financimit dhe ngritjes së kapaciteteve përmenden në dokumente, ato paraqiten kryesisht si objektiva afatmesëm ose afatgjatë, jo si mjete operative për situata krize. Për shembull, PKEK dhe Strategjia e Energjisë nuk parashikojnë instrumente financiare emergjente të shpejta, por theksojnë investimet e ardhshme dhe programet e mbështetura nga donatorët. Koordinimi institucional inkurajohet formalisht përmes mandateve ekzistuese, por gjatë krizave zbatimi praktik mund të përballet me vonesa për shkak të mungesës së stafit, kapaciteteve teknike të kufizuara dhe varësisë nga infrastruktura në zhvillim. Siç u theksua edhe në analizat mbi mungesat e fuqisë punëtore dhe digjitalizimin, gatishmëria digjitale dhe aftësitë teknike të fuqisë punëtore në Kosovë mbeten sfida të vazhdueshme; këto hendeqe janë të pranishme edhe në sektorin energjetik dhe ngadalësojnë reagimin operacional. Kjo sugjeron se arritja e

“Kuadri rregullativ i Kosovës në kontekst të mjaftueshmërisë së prodhimit, tregon se legjislacioni aktual demonstroi reziliencë mesatare, me rezultat të përgjithshëm rreth 74%.”

kapacitetit të plotë të resurseve kërkon investime të vazhdueshme në kapacitete njerëzore dhe teknike.

Për sa i përket shpejtësisë, kuadri rregullativ performon nga niveli i dobët deri të ai mesatar, ku shumica e dokumenteve marrin notë 1 ose 2. Edhe pse disa strategji dhe ligje parashikojnë procedura për koordinim më të shpejtë, si kodet e rrjetit për operim emergjent, sistemet e përmirësuara të monitorimit dhe balancimi i bazuar në treg përmes bashkimit rajonal, këta mekanizma kryesisht janë të varur nga përmirësimet infrastrukturore dhe digjitalizimi në të ardhmen. Shkathtësitë digjitale të kufizuara në pjesë të fuqisë punëtore ekzistuese (shpesh në moshë më të vjetër) ulin efektivitetin praktik të këtyre mekanizmave, duke ngadalësuar reagimin operacional pavarësisht ekzistencës së procedurave formale. Prandaj, investimet në përmirësimin dhe rikualifikimin e fuqisë punëtore janë thelbësore për të siguruar funksionim të plotë operacional dhe performancë më të mirë në këtë dimension. Në praktikë, Kosova ende nuk ka rezerva të mjaftueshme të shpërndarjes dhe ka kapacitet të kufizuar vendor për të reaguar shpejt ndaj rënieve të papritura të termocentraleve ose infrastrukturës së rrjetit (p.sh. mbingarkesa e transformatorëve në nivel shpërndarjeje), gjë që rezulton në ndërprerje më të gjata. Menaxhimi i krizave në kohë reale ngadalësohet më tej nga kufizimet institucionale dhe gatishmëria teknike e kufizuar për ndërhyrje. Si rrjedhojë, forcimi i shpejtësisë kërkon investime infrastrukturore si dhe protokolle operative më të avancuara për të mundësuar veprim më të shpejtë dhe efektiv gjatë goditjeve.

Konkluzione dhe Rekomandimet

Në këtë publikim kemi analizuar goditjen e mjaftueshmërisë (e përkufizuar si ndërprerje e papritur e termocentraleve) si goditja kryesore energjetike me të cilën përballlet sistemi elektroenergjetik i Kosovës. Sistemi i energjisë elektrike në Kosovë ka varësi tejet të lartë në dy termocentrale të vjetruara me qymyr, që e bën sistemin të cenueshëm dhe të lidhur ngushtë me funksionimin e tyre, për shkak të kapaciteteve të kufizuara prodhuese vendore dhe varësisë nga importet. Qëllimi i kësaj analize ishte të shqyrtonte kuadrin ekzistues rregullativ dhe të vlerësonte reziliencën e tij ndaj një goditjeje të tillë, me qëllim të ofrimit të rekomandimeve të politikave të bazuara në evidencë.

Për identifikimin dhe vlerësimin e goditjes së mjaftueshmërisë energjetike është aplikuar metodologjia e analizës së politikave e përshkruar në Kapitullin 2. Procesi ka përfshirë identifikimin dhe përzgjedhjen e ligjeve dhe dokumenteve strategjike kryesore që rregullojnë sektorin elektroenergjetik të Kosovës. Janë përzgjedhur katër ligje dhe tri strategji/plane kombëtare bazuar në relevancën e tyre të drejtpërdrejtë për mjaftueshmërinë e prodhimit, sigurinë e furnizimit dhe planifikimin afatgjatë të energjisë. Secili prej këtyre dokumenteve është vlerësuar përmes kornizës së 4R-ve të Reziliencës — qëndrueshmëri, kapacitetet rezervë, aftësi të mobilizimit të resurseve, dhe shpejtësi — për të përcaktuar nivelin sipas së cilit kuadri rregullativ mund të parashikojë, përballojë dhe reagojë ndaj goditjeve të lidhura me prodhimin. Kjo qasje sistematike ka mundësuar kuantifikimin e niveleve të reziliencës dhe identifikimin e hendeqeve strukturore në kuadrin ekzistues.

Rezultatet e përgjithshme tregojnë se legjislacioni aktual ka reziliencë mesatare, me rezultat rreth 74%. Gjersa anët e forta të kuadrit rregullativ janë te qëndrueshmëria (me vlerësim të përgjithshëm të lartë), analiza tregon se ekziston një bazë e fortë institucionale dhe ligjore me role të përcaktuara qartë dhe planifikim të detyrueshëm. Elemente pozitive shfaqen edhe te mobilizimit i resurseve, veçanërisht përmes angazhimit shumëpalësh, përfshirjes së institucioneve të ndryshme dhe qasjes në financim të jashtëm. Megjithatë, dobësi të ndjeshme shfaqen në kapacitetet rezervë dhe shpejtësinë e reagimit (me vlerësime të ulëta 1–2 nga 3),

“Është thelbësore që të zhvillohen kapacitete të reja vendore të prodhimit për të rritur reziliencën e sistemit dhe sigurinë e furnizimit.”

kryesisht për shkak të mungesës së kapaciteteve rezervë të prodhimit vendor, varësisë nga importet dhe progresit të kufizuar në zhvillimin e kapaciteteve të reja dhe diversifikimin e burimeve energjetike. Tutje, koordinimi i ngadalshëm, veçanërisht në situata kritike që kërkojnë ndërhyrje të shpejtë, dhe varësia në reforma dhe investime të ardhshme e dobësojnë më tej reziliencën, ndërsa infrastruktura e vjetruar e bën situatën edhe më sfiduese.

Gjetjet në këtë analizë kanë implikime praktike për sektorin energjetik të Kosovës, veçanërisht për sektorin e energjisë elektrike. Gjetjet e kësaj analize mund t'i ndihmojnë politikëbërësit që t'i trajtojnë goditjet energjetike (si ndërprerjet e papritura të termocentraleve ose ngjarjet ekstreme klimatike) si elemente kyçe për sigurimin e funksionimit të duhur të sektorit. Hartimi i politikave që rrisin dhe promovojnë reziliencën e sektorit duhet të jetë prioritet kryesor, sidomos duke pasur parasysh ndryshimet e mëdha që sektori ka përjetuar vitet e fundit. Bazuar në rezultatet, në vijim i kemi shtjelluar implikimet dhe kemi propozuar tri rekomandime kryesore.

Së pari, kemi vërejtur se kapacitetet vendore të prodhimit mbeten të kufizuara dhe të gjitha dokumentet zyrtare nënvizojnë nevojën për investime në kapacitete të reja. Ndërprerjet e shpeshta të termocentraleve të vjetruara me qymyr, në kombinim me rritjen e konsumit, e bëjnë sektorin e energjisë elektrike gjithnjë e më të cenueshëm. Mungesa e fleksibilitetit në opsionet e furnizimit dhe variabiliteti i lartë i prodhimit neto e lënë Kosovën shumë të varur nga importet, veçanërisht gjatë dimrit kur kërkesa rritet për shkak të nevojave për ngrohje. Viteve të fundit kanë filluar të shfaqen efektet e ndryshimeve klimatike, duke shtuar një shtresë tjetër cenueshmëria për sistemin. Valët e të nxehtit kanë rritur kërkesën verore në kohë të pikut për shkak të nevojës për ftohje, duke shkaktuar shpeshherë deficit prodhimi (rritje të importeve) edhe në periudha kur Kosova zakonisht eksportonte. Për më tepër, elektrifikimi në rritje (si automjetet elektrike) do të rrisë kërkesën dhe do të kërkojë zgjerim shtesë të kapaciteteve, duke rritur më tej cenueshmërinë nëse nuk zhvillohen kapacitete të reja prodhimi.

Për këto arsye, është thelbësore të zhvillohen kapacitete të reja vendore të prodhimit për të rritur reziliencën e sistemit dhe sigurinë e furnizimit. Prandaj, politikëbërësit duhet të krijojnë një kuadër rregullativ të qëndrueshëm që mundëson zbatim të shpejtë dhe të përsëritshëm të projekteve të reja. Ankandi i parë konkurrues për energjinë solare ishte hap i rëndësishëm përpara, por nuk është organizuar ende një ankand pasues. Mësimet e nxjerra nga ankandi i parë duhet të përdoren për të hartuar ankande të ardhshme të përsëritshme. Duke pasur parasysh se Strategjia e Energjisë synon 1400 MW kapacitete shtesë deri në vitin 2031, hendeku ndërmjet ambicies dhe zbatimit mbetet i madh. Një faktor tjetër që mund të vonojë zhvillimin e kapaciteteve të reja është mosmarrëveshja politike ndërmjet partive politike (ndryshimi i vazhdueshëm i planeve dhe prioritetëve). Gjatë viteve janë propozuar disa plane që nuk janë realizuar, kryesisht për shkak të ndarjeve politike. Prandaj, është i nevojshëm një konsensus i gjerë politik ndërmjet partive politike për t'i mbrojtur investimet afatgjata dhe për të siguruar që projektet energjetike nuk i ekspozohen rrezikut politik.

Së dyti, Kosova duhet të rrisë kapacitetet rezervë institucionale dhe t'i forcojë kapacitetet për të reaguar ndaj goditjeve përmes formimit të task-forcave të posaçme për energji dhe hartimit të politikave të mençura dhe adaptive. Viteve të fundit, sektori energjetik është përballur me ndryshime të mëdha si çmimet e larta të energjisë, rëniet e paplanifikuara të termocentraleve dhe rritja e temperaturave, të cilat kërkojnë vendimmarrje të shpejtë dhe inovative. Disponueshmëria e kufizuar e ekspertizës teknike brenda institucioneve, si dhe qasja e kufizuar në ekspertizë të pavarur, kufizojnë më tej aftësinë për reagim efektiv gjatë periudhave kritike. Rritja e kapaciteteve institucionale dhe forcimi i qasjes në ekspertizë teknike do të përmirësonte proceset vendimmarrëse dhe do të kontribuonte në rritjen e reziliencës së sektorit. Edhe pse masat ndërhyrëse në sektorin energjetik janë të kufizuara në afat të shkurtër (p.sh. ndërtimi i një termocentrali kërkon vite), masat afatshkurtra mund ta ndihmojnë sistemin që t'iu bëjë ballë periudhave kritike. Këto përfshijnë masa të targetuara të eficiencës së energjisë për reduktimin e kërkesës në kohë të pikut, si dhe vendosjen e objektivave për operatorët energjetikë për përmirësimin e performancës së sistemit. Këto ndërhyrje mund të ulin cenueshmërinë ndërkohë që zhvillohen investimet afatgjata.

Së treti, politikëbërësit duhet të hartojnë plane gjithëpërfshirëse veprimi për përgatitje ndaj rreziqeve, me qëllim që të parashikohen dhe menaxhohen rreziqet nga goditjet e mundshme në të ardhmen. Politikëbërësit duhet të mbështeten në përvojat e viteve të fundit (çmimet e larta të energjisë apo ndërprerjet e shpeshta të furnizimit) për të kaluar nga qasja reaguese në qasje më proaktive të planifikimit. Përgatitja ndaj goditjeve të ardhshme kërkon vlerësim sistematik të rreziqeve potenciale, si ato që lidhen me furnizimin dhe çmimet e paqëndrueshme të lëndëve djegëse, ngjarjet ekstreme klimatike (p.sh. valët e të nxehtit), rëniet e blloqeve të prodhimit ose ndërprerjet rajonale (p.sh. deficit energjetik). Vlerësime të tilla do t'u mundësonin politikëbërësve të planifikojnë paraprakisht përmes planeve konkrete të veprimit, të cilat mund të shërbejnë për hartimin e politikave efektive dhe, në fund, për forcimin e sektorit energjetik dhe mbrojtjen e konsumatorëve.

“Politikëbërësit duhet të mbështeten në përvojat e viteve të fundit (çmimet e larta të energjisë apo ndërprerjet e shpeshta të furnizimit) për të kaluar nga qasja reaguese në qasje më proaktive të planifikimit.”

Bibliografia

- 1 Departamenti i Shtetit SHBA, Zyra e Historianit (n.d.) Embargo e naftës, 1973–1974
- 2 Downey, L. (2022) Kriza energjetike e vitit 1979: Përkufizimi, historia, shkaqet dhe ndikimi. Investopedia (Blog).
- 3 Agjencia Ndërkombëtare e Energjisë (n.d.) Siguria energjetike: Qasje e besueshme dhe e përbalueshme në të gjitha lëndët djegëse dhe burimet e energjisë. Agjencia Ndërkombëtare e Energjisë.
- 4 Jasiūnas, J., Lund, P. D. and Mikkola, J. (2021) Përmbledhje. Rishikime të Energjisë së Rinovueshme dhe të Qëndrueshme.
- 5 Agjencia Ndërkombëtare e Energjisë. (2015) Bërja e sektorit të energjisë më të qëndrueshëm ndaj ndryshimeve klimatike. Agjencia Ndërkombëtare e Energjisë.
- 6 ZRRE, Raport Vjetor, 2024
- 7 Strategjia Kombëtare e Energjisë e Republikës së Kosovës 2022-2031
- 8 Klasifikuar bazuar në dokumentin e OECD-së (2014) "Udhëzimet për analizën e sistemeve të reziliencës: Si të analizohen rreziqet dhe të ndërtohet një udhërrëfyes për reziliencë". Botim i OECD.
- 9 ENTSO-E. (2011) Metodologjia për Retrospektivën e Mjaftueshmërisë së Sistemit. Rrjeti Evropian i Operatorëve të Sistemit të Transmetimit për Energjinë Elektrike
- 10 Komisioni Australian i Tregut të Energjisë (pa datë) Besueshmëria. Komisioni Australian i Tregut të Energjisë.
- 11 Shih fusnotën 4.
- 12 Ukyab, K.T. & Simonovich, L. (2025) Fuqizimi i rezistencës kibernetike në sektorin e energjisë. Forumi Ekonomik Botëror.
- 13 Agjencia Ndërkombëtare e Energjisë (2025) Mësime të Tregut të Gazit nga Kriza Energjetike 2022–2023. Agjencia Ndërkombëtare e Energjisë.
- 14 Komisioni Evropian. (2024) E Ardhmja e Konkurrueshmërisë Evropiane. Komisioni Evropian.
- 15 Amelang, S., et al., (2023) Lufta në Ukrainë: Ndjekja e ndikimeve në politikën gjermane të energjisë dhe klimës. Teli me energji të pastër.
- 16 Reuters (2024) Tohoku Elec i Japonisë rifillon reaktorin Onagawa pas një ndërprerjeje 13-vjeçare. Reuters.
- 17 Shih fusnotën 6.
- 18 Nenet 4, 7, 10, 46, 52, 65, 92, 122, 131, dhe 142 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.
- 19 LIGJI NR. 05/L-081 PËR ENERGJINË
- 20 LIGJI NR. 05/L-085 PËR ENERGJINË ELEKTRIKE
- 21 LIGJI NR. 06/L-079 PËR EFIÇIENCËN E ENERGJISË
- 22 LIGJI NR. 05/L-084 PËR RREGULLATORIN E ENERGJISË
- 23 SAIDI/SAIFI - Indeksi i Kohëzgjatjes/Frekuencës Mesatare të Ndërprerjeve të Sistemit
- 24 Politikat dhe masat 43-44.
- 25 Politikat dhe masat 47.
- 26 Politikat dhe masat 51.
- 27 Politikat dhe masat 60-61.
- 28 Smolica, G. and Kajtazi, O. (Në botim e sipër) Ndryshimet në treg të punës si pasojë e automatizimit: Vlerësim i kuadrit rregullativ të Kosovës kundrejt ndryshimeve të tregut të punës. Re-ACT Lab and Friedrich Ebert Stiftung.
- 29 Zeneli, S. and Gajtani, E. (2025) Ndarja digjitale: Nga hendeku në goditje: Vlerësim i kuadrit rregullativ të Kosovës kundrejt hendekut digjital. Re-ACT Lab and Friedrich Ebert Stiftung..
- 30 Shih fusnotën 27.

